



Universiteti Publik "KADRI ZEKË" Public University			
Data e aplikimit: 28.04.2022			
Kodi i aplikimit: 051		740	



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union



**Zyra për bashkëpunim Ndërkombëtar e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan,  
Shpall këtë:**

## **Thirrje për aplikime për shkëmbim studentor në Universitetin "Celal Bayar" Manisa, Turqi**

Universiteti "Kadri Zeka" është pjesë e projektit KA107 ICM, Erasmus +, në partneritet me Universitetin e Manisas në Turqi.

Numri i Projektit Erasmus + KA107 (ICM) 2019-1-TR01-KA107-073710

Programi Erasmus + KA107 ose Shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i studentëve dhe ECTS (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit Manisa Celal Bayar, Manisa, Turqi dhe Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e studentëve nga Universiteti "Kadri Zeka" - Gjiilan për studim dhe trajnim / veprimtari të lëvizjes në fushën:

- Juridik
- Menaxhment
- Marketing
- Banka, Financa dhe Kontabilitet
- Shkenca Kompjuterike dhe
- Edukim

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti:

800 Euro në muaj dhe 275 Euro për udhëtim sipas Distance Calculator të Erasmus +  
([http://ec.europa.eu/.../erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/.../erasmus-plus/tools/distance_en.htm)).

Granti i udhëtimit do të paguhet para lëvizjes nga projekti dhe mbulohet nga Universiteti pritës.

Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritesit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtese për pjesëmarrësit.

### **APLIKIMI dhe PËRZGJEDHJA**

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e notave;
- CV (në gjuhën angleze);
- Një leter motivimi (në gjuhën angleze);



- Vërtetim studentit (i leshuar nga fakulteti juaj që konfirmon nivelin tuaj dhe vitin e studimit gjatë këtij viti akademik, jo me të vjetër se 30 ditë);
  - Kopje e Pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, foton dhe të dhënat personale) ose Letërnjoftimit;
  - Certifikata e gjuhës angleze ose turke;
- Per programet e ofruara në gjuhën angleze ose turke kërkohet niveli i gjuhës minimurni B2.

**Shënim:**

- 1) Studenti duhet të ketë përfunduar të paktën 2 semestra në programin në të cilin janë regjistruar. Deri në ditën e fundit për aplikim, studentët të cilët kanë notë mesatare mbi 8.00 mund të aplikojnë në program.
- 2) Që studentët të marrin një grant të ICM-së, ata duhet të kalojnë të paktën një semester (3 muaj) në universitetin pritës. Granti i mobilitetit të studenteve të ICM mbulon minimumi 90 ditë.
- 3) Studentët që do të marrin pjesë në programet e mobilitetit janë të detyruar të marrin kurse nga universiteti pritës të paktën me vlerë 30 ECTS (rreth 5 kurse).

**Vleresimi i aplikuesve:**

Mesatarja e notes: 50%  
Gjuhe e huaj: 50%

**PROCEDURA E APLIKIMIT**

- Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (kopje fizike) ose përmes emailit [internatioanlooffice@uni-gjilan.net](mailto:internatioanlooffice@uni-gjilan.net), mes datave **28 Prill 2022 dhe 06 Maj 2022**. Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.

- Rezultatet e aplikimit do të shpallen në [www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)

Për çdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.

Me respekt,  
Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka  
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar

